


01-290



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-32607/24 dt. 04.03.2024, të pronarit Betim Musliu nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën/shtëpi individuale të banimit, ndërtuar në kuader të parcelës ndërtimore “L-12-14”, të bllokut urban “L-12”, të tërësisë hapësinore “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në rr. “Sabit Uka” nr. 19, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 14.05.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Betim Musliu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-32607/24 dt. 04.03.2024, përdorimi i ndërtesës shtëpi individuale të banimit, me etazhitet P+2, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-118387/22 dt. 21.06.2022, në parcelën kadastrale nr. 260-18, ZK Çagllavicë, konkretisht në kuader të parcelës ndërtimore “L-12-14”, të bllokut urbane “L-12”, të tërësisë “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Sabit Uka” ku ka dalje hyrja e kësaj ndërtese me numër: 19, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Betim Musliu nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-32607/24 dt. 04.03.2024, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shtëpi individuale të banimit, me etazhitet P+2, e ndërtuar në kuader të parcelës ndërtimore “L-12-14”, të bllokut urban “L-12”, të tërësisë hapësinore “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 260-18, ZK Çagllavicë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-118387/22 dt. 21.06.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-25331/24 dt. 28.02.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës

Faqe 1 prej 3

së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Përparim Çalaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Liridon Sylejmani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Faton Turkaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Ajet Ramadani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Rexhe Çalaj; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti e licensuar Festim Islami me nr. të licensës 12;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shtëpi individuale e banimit mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa/shtëpi individuale e banimit mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesen/shtëpi individuale të banimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Çertifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Çertifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuarit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-32607/24 DT. 14.05.2024**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu


Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

